

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta e Unionit Evropian
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	III semestri VI
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Hajredin Kuçi
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda e Drejta e Unionit Evropian përfshinë një cikël ligjëratesh, përgjatë një semestri, të dizajnuara për të pajisur studentët me njohuritë themelore mbi Unionin Evropian, të Drejtën e UE-së dhe funksionimin e UE-së.</p> <p>Konkretizimi i njohurive të përmbledhura si më sipër përfshinë temat mbi trajektoren historike të Unionit, duke u nisur nga bashkësitë e para evropiane e deri te Unioni Evropian, gjithnjë nën vështrimin nga prizmi juridik.</p> <p>Ligjërimi përfshinë shtjellimin e temave dhe aspekteve themelore të UE-së dhe të drejtës së UE-së, duke filluar nga traktatet, nga ai i Parisit e deri tek Traktati i Lisbonës; njohuritë mbi institucionet kryesore dhe ndihmëse të UE-së; nocionet, parimet, burimet e së Drejtës së UE; procedurat legjislative në BE; tregun e brendshëm dhe liritë themelore të tij; Unionin ekonomik dhe monetar me politikat përkatës; konkurrencën, mbrojtjen e konsumatorit, të drejtat themelore, sipas Kartës së UE-së; procesin e zgjerimit, procesin e stabilizim asocimit me fokus rastin e Kosovës dhe çështjet aktuale të UE-së.</p> <p>E konceptuar si e tillë, lënda ngërthen në vete mundësitë reale për një mësim përveç torik dhe praktik që u ofrohet studentëve të drejtësisë, duke trajtuar raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë të UE-së; çështje që kanë të bëjnë me aspektet praktike të politikave të UE-së; raste dhe</p>

	<p>dokumente mbi zgjerimin e UE-së.</p> <p>Vështrimi do të jetë kryesisht i natyrës juridike, i mbështetur në traktate, praktikë gjyqësore dhe të drejtën institucionale të UE-së. Kjo përplotësohet me temat dhe çështjet aktuale (praktitke) të UE-së e që mund të jenë të natyrës ekonomike, politike, gjeostrategjike – përveç atyre juridike.</p>
<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>E Drejta e Unionit Evropian, si një ndër lëndët më të rëndësishme për studimet në drejtësi, ka një dinamikë tejet të shpejtë të zhvillimit. Si e tillë, lënda mbi të Drejtën e Unionit Evropian sjell risitë e saj gjatë evolucionit dhe ngritjes së saj si disiplinë shkencore. Megjithatë kjo lëndë ka si qëllim parësor, ofrimin për studentë të njohurive të përgjithshme dhe atyre konceptuale mbi të Drejtën e Unionit Evropian. Në këtë kuadër, lënda e së Drejtës së UE-së do t’u ofrojë studentëve mundësi që t’i zhvillojnë njohuritë e tyre mbi sistemin juridik të Unionit Evropian dhe mënyrën e funksionimit të tij. Konsideratë të veçantë do t’i jepet Traktateve themeluese të Komuniteteve të Para që shërbyen si bazë për themelimin e mëvonshëm të vet UE-së. Lënda përfshin konceptet themelore të së Drejtës së UE-së, strukturën ligjore, institucionet, vendim-marrjen, burimet e së drejtës, Gjykata e Drejtësisë së UE-së në veçanti, raporti ndërmjet të Drejtës së UE-së dhe të Drejtës kombëtare të shteteve anëtare të UE-së, dhe efektet e së Drejtës së UE, tregun e brendshëm dhe liritë themelore të tij, unionin ekonomik dhe monetar, konkurrencën dhe mbrojtjen e konsumatorit, Kartën e të drejtave themelore të UE-së, zgjerimin e UE-së dhe kriteret e anëtarësimit në UE, relacionet e UE-së dhe Ballkanit Perëndimor në veçanti relacionet e Republikës së Kosovës me UE-në.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Njohuri të përgjithshme për themelimin dhe funksionimin e Unionit Evropian • Njohuri të përgjithshme për të Drejtën e UE-së, burimet, efektin juridik, zbatimin dhe

	<p>interpretimin e saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohur lidhur me strukturën institucionale dhe rolin e tyre ne proceset e vendimmarrjes në UE • Njohuri te përgjithshme për Kartën e të Drejtave themelore të UE-së, për procesin e zgjerimit, relacionet e UE-së më Ballkanin Perëndimor. • Njohuri për tregun e brendshëm të UE-së, konkurrencën dhe mbojtjen e konsumatorit • Njohuri konkrete lidhur me procesin e anëtarësimit të Kosovës në UE duke përfshirë këtu relacionet në mes të UE-së dhe Kosovës, mekanizmat e UE-së në Kosovë, Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe krejt në fund njohuri të përgjithshme për çështjet aktuale më UE.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.25	10	2.5
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	5	2	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	12	2	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet, etj.	3	2	6
Totali			155

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Kjo lëndë ndër të tjera ofron një qasje inovative sa i takon mësimdhënies për të Drejtën e Unionit Evropian. Në vend të mësimdhënies si doktrinë sistematike, ne do të punojmë me një mori problemesh të dizajnuara për të përcjellë njohuritë</p>
-------------------------------------	---

	<p>bazë në mënyrë dinamike, realiste dhe komparative. Metodatat akademike janë të ndryshueshme dhe janë sfida e veçantë. Përqendrimi në mendimin kritik, analitik dhe kreativ do të jetë filozofia bazë e organizimit dhe mbarëvajtjes së kësaj lënde. Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet diskutimit dhe pjesëmarrjes aktive të studentëve gjatë orëve të mbajtjes së kësaj lënde. Studentët inkurajohen që të lexojnë literaturë shtesë në mënyrë që të jenë në gjendje të analizojnë dhe kuptojnë problematikën e shtruar për diskutim përgjatë gjithë semestrit që i dedikohet kësaj lënde.</p>														
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Lidhur me lëndën në fjalë organizohet një Provim i ndërmjetëm (kolokvium) i cili maksimalisht vlerësohet me 30 pikë të cilat i shtohen pastaj pikëve të fituara në provimin përfundimtar. Nota përfundimtare rrumbullaksohet duke mbledhur piket nga kolokviumi dhe provimi përfundimtar. Në bazë të pikëve si më poshtë përcaktohet edhe nota:</p> <table data-bbox="716 1073 1256 1360"> <thead> <tr> <th>Vlerësimi në %</th> <th>Nota përfundimtare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>91-100</td> <td>10 (dhjetë)</td> </tr> <tr> <td>81-90</td> <td>9 (nëntë)</td> </tr> <tr> <td>71-80</td> <td>8 (tetë)</td> </tr> <tr> <td>61-70</td> <td>7 (shtatë)</td> </tr> <tr> <td>51-60</td> <td>6 (gjashtë)</td> </tr> <tr> <td>0-50</td> <td>5 (pesë)</td> </tr> </tbody> </table>	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare	91-100	10 (dhjetë)	81-90	9 (nëntë)	71-80	8 (tetë)	61-70	7 (shtatë)	51-60	6 (gjashtë)	0-50	5 (pesë)
Vlerësimi në %	Nota përfundimtare														
91-100	10 (dhjetë)														
81-90	9 (nëntë)														
71-80	8 (tetë)														
61-70	7 (shtatë)														
51-60	6 (gjashtë)														
0-50	5 (pesë)														
<p>Literatura</p>															
<p>Literatura bazë:</p>	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Paul Craig, Grainne De Burca, The Evolution of the European Union Law Oxford University Press, third edition 2021.</i> • <i>Paul Craig and Grainne DE Burca “ EU LAË- Text, Cases and materials” Fourth Edition, 2008 (e përkthyer ne gjuhën shqipe)</i> <hr/> <p><i>Të tjera:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Paul Craig, Grainne De Burca, The</i> 														

	<p><i>Evolution of the European Union Law Oxford University Press, third edition 2021;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Christian Dadomo and Noëlle Quénivet, EUROPEAN UNION LAW, Third Edition, British Library Cataloguing in Publication Data, 2020;</i> • <i><u>Hajredin Kuci, E Drejta Evropiane ne Kosove, Grup Autoresh, Hyrje ne sistemin ligjor te Kosoves, botues ADK, 2019. Prishtine fq.71-102</u></i> • <i>Iyola Solanke, EU Law, LONGMAN LAW SERIES, Library of Congress Cataloging-in-Publication Data, First Edition 2015;</i> • <i>Andrea Biondi, Piet Eeckhout, Stefanie Ripley, EU Law After Lisbon Treaty, Oxford University Press, Published in United States New York 2012.</i> • <i>Paskal Milo, “Bashkimi Evropian” (Ideja, Integrimi, Identiteti, e Ardhmja), Tiranë 2002.</i> <i>Damian Chalmers, Adam Tomkins, European Union Public Law, Cambridge University Press 2007;</i> • <i>Anthony Luzzatto Gardner and Stuart E. Eizenstat, New Treaty New Influence: Europe’s Chance to Punch Its Weight, Foreign Affairs, March/April 2010</i> • <i>Paul Craig and Grainne DE Burca “ EU LAW- Text, Cases and materials” Fourth Edition, 2008 faqe 268-304.</i> • <i>Erjona Canaj dhe Sokol Bana, “E Drejta e Bashkimit Evropian” Tiranë 2010, faqe 174-181.</i> • <i>Ralph H. Folsom “Principles of European Union Law” Second Edition 2009 Thomson Reuters, faqe 75-87.</i> • <i>Tim Corthaud “Plus ça change, plus c’est la même chose: A Comparison of the Lisbon Treaty and the Constitutional Treaty” (2008). Maastricht Journal of European and Comparative Law (17).</i> • <i>G de Búrca, The Lisbon Treaty No-Vote: An Irish Problem or a European Problem? (2009).</i> • <i>Erjona Canaj dhe Sokol Bana, “E Drejta e Bashkimit Evropian” Tiranë 2010, 37-40.</i>
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Doracaku për Përgatitjen e Provimit të Jurisprudencës, dhjetor 2015, fq. 802-844.</i> • <i>Traktati mbi Unionin Evropian (TEU) dhe Traktati për Funkcionimin e Unionin Evropian (TFEU), përmbajnë dispozita më të hollësishme.</i> • <i>Paul Craig and Grainne DE Burca “ EU LAË- Text, Cases and materials” Fourth Edition, 2008 faqe 38-80.</i> • <i>Diego Acosta “The Good, the Bad and the Ugly in EU Migration Laë: Is the European Parliament Becoming Bad and Ugly? (2009) European Journal of Migration and Laë</i> • <i>Paul Craig and Grainne DE Burca “ EU LAË- Text, Cases and materials” Fourth Edition, 2008 faqe 66-76.</i> • <i>John Fairhurst “Laë of the European Union”, 7th edition 2010, British Library Cataloguing-in-Publication Data, faqe 162-187.</i> • <i>Lexoni nenin 267 të TFEU (paraprakisht neni 234 i Traktatit per KE-në).</i> • <i>Paul Craig and Grainne DE Burca “ EU LAË- Text, Cases and materials” Fourth Edition, 2008.</i> • <i>John Fairhurst “Laë of the European Union”, 7th edition 2010, British Library Cataloguing-in-Publication Data.</i> • <i>Margot Horspool & Mattheë Humphreys, “European Union Laë” Oxford University Press, 2008.</i> • <i>Versioni I Kartes ne shqip-përkthim nga MIE e Shqipërisë.</i> • <i>Nenet 34-36 të TFEU (më heret nenet 28-30 të KE).</i> • <i>Margot Horspool & Mattheë Humphreys, “European Union Laë” Oxford University Press, 2008.</i> • <i>John Fairhurst “Laë of the European Union” Seventh Edition 2010, British Library Cataloguing-in-Publication Data.</i> • <i>Traktati mbi Unionin Evropian (TEU) dhe Traktati për Funkcionimin e Unionin Evropian (TFEU), përmbajnë dispozita më</i>
--	--

	<p>të hollësishme.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anton Bebler “Hyrje ne Integrimet Evropiane”, përkthyer nga Kolegji Universitar “Victory” Prishtinë, faqe 202-212. • Caner Öinkel “The Eastern Enlargement of the European Union”, Lambert Academic Publishing 2009. • Deirdre Curtin, “Executive Power of the European Union: Law, Practices, and the Living Constitution”, Oxford 2009, fq. 69-103. • Raportet e Progresit për Kosovën 2005 deri aktualisht • Strategjitë e Zgjerimit të UE-së • Marrëveshja e Stabilizimi Asocimit në mes të Kosovës dhe UE-së • Ueb faqet e institucioneve si në vijim: Komisioni Evropian, Gjykata e Drejtësisë së UE-së, Ministria e Integritimit Evropian e Republikës së Kosovës
<p>Literatura shtesë:</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ueb-faqja e UE-së: http://europa.eu/index_en.htm • Gjykata Evropiane e Drejtësisë (ECJ): http://curia.europa.eu/ • EURLEX për legjislacionin e KE-së: http://europa.eu/documents/eur-lex/index_en.htm • Traktatet e UE-së: http://eur-lex.europa.eu/en/treaties/index.htm
<p>Plani i dizajnuar i mësimit:</p>	
<p>Java</p>	<p>Ligjërata që do të zhvillohet</p>
<p><i>Java e parë:</i></p>	<p>Tema:</p> <p>Historik i përgjithshëm mbi themelimin e Bashkësive të para Evropiane (Bashkësia për thëngjill dhe Çelik, Bashkësia Ekonomike Evropiane dhe Euroatomi), pastaj mbi themelimin e Unionit Evropian (traktati i Mاستrihtit 1993), Traktati i Amsterdimit, Nicës e deri të Traktati i Lisbonës.</p>
<p><i>Java e dytë:</i></p>	<p>Tema:</p>

	<p>Nocioni, Kuptimi i të Drejtës së UE-së, Burimet primare dhe sekondare, Relacioni i të Drejtës së UE-së me të Drejtat e vendeve anëtare dhe të Drejtën Ndërkombëtare. Zbatimi i të drejtës së UE-së-parimi i efektit direkt dhe parimi i Supremacisë) dhe parimet e veçanta të së drejtës së UE-së</p>
Java e tretë:	<p>Tema:</p> <p>Traktati i Lisbonës (Traktati mbi Bashkimin Evropian dhe Traktati mbi Funkionimin e Bashkimit Evropian). Risitë, ndryshimet dhe funksionimi i UE-së sipas këtij Traktati.</p>
Java e katërt:	<p>Tema:</p> <p>Institucionet Kryesoere të Unionit Evropian: përbërja, roli, kompetencat dhe funksionet e tyre. Këshilli Evropian Parlamenti Evropian Këshilli Komisioni Gjykata e Drejtësisë së UE-së Banka Qendrore Evropiane</p> <p>Institucionit apo trupat ndihmëse / specializuar të UE-së:</p> <p>Shërbimi i Veprimit të Jashtë Evropian Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social Komiteti Evropian i Rajoneve Banka Evropiane e Investimeve Ombudspersoni Evropian Mbikëqyrësi Evropian e i Mbrojtjes së të Dhënave</p>
Java e pestë:	<p>Tema:</p> <p>Gjykata e Drejtësisë së Unionit Evropian - Jurisdiksioni, Funksionet, Kompetencat, Relacioni me Gjykatat Nacionale - Analizë e Rasteve nga praktika gjyqësore</p>

Java e gjashtë:	<p>Tema:</p> <p>Procesi i Legjislativ/vendimmarrës në kuadër të UE-së, aspekti juridik.</p> <p>Procedura e rregullt legjislative</p> <p>Procedurë e veçantë legjislative</p> <p>Roli i institucioneve të UE-së në këtë proces.</p> <p>Roli i Parlamenteve nacionale në procesin legjislativ të UE-së.</p>
Java e shtatë:	<p>Tema:</p> <p>Karta e të Drejtave Themelore e Unionit Evropian E Fuqia juridike, zbatimi i saj, dallimet dhe ngjashmëritë me aktet tjera ndërkombëtare të kësaj natyre.</p>
Java e tetë:	<p>Provimi i Ndërmjetëm</p>
Java e nëntë:	<p>Tema:</p> <p>Tregu i Brendshëm i Unionit Evropian</p> <p>Liritë themelore të Tregut të brendshëm-Aspekti juridik</p>
Java e dhjetë:	<p>Tema: Konkurrenca dhe Mbrojtja e Konsumatorit në kuadër të Unionit Evropian</p>
Java e njëmbëdhjetë:	<p>Tema:</p> <p>Unioni Ekonomik dhe Monetar-Politika Ekonomike dhe Monetare</p> <p>Roli i Bankës Qendrore Evropiane</p> <p>Sistemi Evropian i Bankave Qendrore</p> <p>Komiteti Ekonomik dhe Financiar</p>

	<p>Eurogrupi Komiteti Ekonomik Këshilli i çështjeve ekonomike dhe financiare (Ecofin)Unioni Bankar</p>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<p>Tema: Zgjerimi i Unionit Evropian</p> <p>Fazat e Zgjerimit; -Kriteret formale dhe jo formale për anëtarësim në Unionin Evropian.</p>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<p>Tema: Ballkani Perëndimor dhe UE Procesi i Stabilizim Asocimit Republika e Kosovës dhe EU Mekanizmi Përcjellës i Procesit të Stabilizim Asocimit Dialogu i Procesit të Stabilizim Asocimit Raportet e Progresit Marrëveshja e Stabilizim Asocimit në mes të Kosovës dhe UE-së: Negocimi, inicializimi, nënshkrimi, ratifikimi dhe hyrja në fuqi dhe zbatimi i saj. Plani i Kombëtar për zbatimin e MSA-së</p>
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	<p>Tema: Çështjet aktuale në Unionin Evropian</p>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<p>Provim Përfundimtar</p>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p><i>Studentët duhet të jenë prezent, të paktën 80 përqind të fondit të ligjëratave dhe ushtrimeve. Studentët kërkohet të jenë pjesëmarrës aktivë në ligjëratat, ushtrime dhe seminare/prezantime.</i></p> <p><i>Ligjëratat janë të obligueshme.</i></p> <p><i>Ushtrimet janë të obligueshme.</i></p> <p><i>Pjesëmarrja ne kolokvium u mundësohet studentëve që janë të rregullt në ligjëratat dhe ushtrime.</i></p>

